




Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E ZVEÇANIT OPŠTINA ZVEÇAN ZVEÇAN MUNICIPALITY	
Mjesia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	CO
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	P-3-4/26-1
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2
Data Datum Date	31. 03. 2026



Opština Zvečan
Komuna e Zveçanit
Municipality of Zvečan

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika c) dhe nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neneve 19 dhe 20 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 44 dhe nenit 59, paragrafi 2 të Ligjit nr. 08/L-277 për Sportin, Kuvendi i Komunës së Zveçanit, me propozim të Komitetit për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit paraprak dhe votimit, në mbledhjen e tij të 3-të (tretë) të rregullt në vitin 2026, të mbajtur më datë 31.03.2026, nxjerr:

V E N D I M

për miratimin e Rregullores Komunale për mënyrën, kushtet dhe prioritetet e shfrytëzimit të sallës sportive në Zvečan

Neni 1

Miratohet Rregullorja Komunale për mënyrën, kushtet dhe prioritetet e shfrytëzimit të sallës sportive në Zvečan.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është teksti i Rregullores Komunale për mënyrën, kushtet dhe prioritetet e shfrytëzimit të sallës sportive në Zvečan.

Neni 3

Me Rregulloren Komunale nga neni 1 i këtij vendimi rregullohen:

1. mënyra, kushtet dhe prioritetet e shfrytëzimit të sallës sportive në pronësi të komunës;
2. qëllimi dhe funksioni i sallës sportive;
3. e drejta dhe mënyra e shfrytëzimit të sallës sportive;
4. rregullat themelore të shfrytëzimit të sallës sportive;
5. lartësia dhe baza e pagesës së tarifës për shfrytëzim;
6. kushtet për lirim nga pagesa;
7. kontrolli, mbikëqyrja, masat ndëshkuese dhe transparenca në zbatimin e rregullores.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi dhe të rregullores nga neni 1 i këtij vendimi, kompetente është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ndërsa për zbatimin e saj të drejtë dhe ligjor kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë nga dita e dërgimit të organi mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për Rishqyrtimin Administrativ të Akteve Komunale, si dhe 7 ditë nga dita e publikimit publik në tabelën e shpalljeve ose në faqen zyrtare të internetit të komunës.

Arsyetim

Me tekstin e Rregullores Komunale për mënyrën, kushtet dhe prioritetet e shfrytëzimit të sallës sportive në Zveçan është paraparë që, në mënyrë unike, transparente dhe juridikisht të rregulluar, të rregullohet shfrytëzimi i sallës sportive në pronësi të Komunës së Zveçanit. Me këtë rregullore përcaktohen qëllimi dhe fushëveprimi i aktit, përkufizimet e nocioneve themelore, kompetencat dhe përgjegjësitë e komunës në fushën e sportit, funksioni i sallës sportive, e drejta dhe mënyra e shfrytëzimit të saj, si dhe rregullat themelore të rendit shtëpiak.

Rëndësia e veçantë e nxjerrjes së kësaj rregulloreje qëndron në faktin se me të përcaktohet qartë kush ka të drejtë ta shfrytëzojë sallën sportive, në çfarë kushtesh mund të shfrytëzohet salla, në çfarë mënyre lidhet marrëveshja për shfrytëzim, si dhe cilat janë obligimet e shfrytëzuesve lidhur me ruajtjen e hapësirës, respektimin e rendit dhe përdorimin e ligjshëm të objektit. Me rregullore po ashtu është paraparë që salla sportive të shfrytëzohet për aktivitete me interes publik, manifestime publike, përmbajtje edukative dhe kulturore, rekreacion sportiv, si dhe aktivitete të grupeve formale dhe joformale në përputhje me planet lokale të zhvillimit.

Me nxjerrjen e këtij Vendimi dhe miratimin e Rregullores së lartcekur sigurohen siguria juridike, zbatimi unik i rregullave, menaxhimi transparent i infrastrukturës sportive komunale dhe kushtet e rregulluara qartë për shfrytëzimin e sallës sportive në Zveçan.

Duke pasur parasysh se Kuvendi i Komunës është kompetent për nxjerrjen e akteve të tilla të përgjithshme, si dhe se ekziston nevoja që fusha e shfrytëzimit të sallës sportive të rregullohet në mënyrë të qartë, të ligjshme dhe të zbatueshme, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.



Kryetari i Kuvendit Komunal
të Zveçanit

Dr Srdan Milosavljević



Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA E ZVEÇANIT КОМУНА ЗВЕЧАН ZVECAN MUNICIPALITY			
Mjeshtë Org. Org. Jedin. Org. Unit.	00	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	P-3-4/26
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	6	Data Datum Date	31. 03. 2026



Opština Zvečan
Komuna e Zveçanit
Municipality of Zvečan

**RREGULLORJA KOMUNALE Nr. 01/2026 PËR MËNYRËN,
KUSHTET DHE PRIORITETET E SHFRYTËZIMIT TË
PALESTRËS SPORTIVE NË ZVEÇAN**

Zvečan 31.03.2026.vite

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c) dhe nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 9 dhe nenit 19, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Zveçanit, nenit 19 dhe nenit 20 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe nenit 44 dhe nenit 59, paragrafi 2 të Ligjit nr. 08/L-277 për Sportin, Kuvendi Komunal i Zveçanit, në mbledhjen e tij të 3(tretë) të rregullt, të mbajtur më 31.03. 2026, miraton këtë:

RREGULLORE KOMUNALE PËR MËNYRËN, KUSHTET DHE PRIORITETET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SPORTIVE NË ZVEÇAN

Neni 1.

Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen mënyra, kushtet dhe prioritetet e shfrytëzimit të Pallatit të Sportit në pronësi të Komunës së Zveçanit, me qëllim të menaxhimit efikas, racional dhe transparent të pallatit të sportit për:

1. Aktivitetet me interes publik dhe nevojat e komunës.
2. Manifestimet dhe ngjarjet publike: organizimin dhe mbështetjen e tubimeve me rëndësi për komunën.
3. Edukimin dhe kulturën: përmbajtje edukative, programe jofitimprurëse për fëmijë, ngjarje dhe projekte kulturore.
4. Rekreacionin sportiv dhe shëndetin: aktivitete rekreative, manifestime sportive.
5. Nevojat e përgjithshme: aktivitete që realizohen nga grupet formale dhe joformale, të cilat janë në përputhje me planet lokale të zhvillimit.

Neni 2.

Përkufizimet

Në kuptim të kësaj rregulloreje:

1. DKRS – nënkupton Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
2. Palestër sportive është hapësira në pronësi ose menaxhim të Komunës.
3. Aktivitet komercial është çdo aktivitet që nënkupton realizimin e të hyrave në bazë të biletave, anëtarësive, qirasë, marketingut ose ndonjë forme tjetër të përfitimit financiar.
4. Aktivitet sportiv jofitimprurës është aktiviteti që zhvillohet pa realizim fitimi

dhe të hyrat eventuale të të cilit shërbejnë ekskluzivisht për mbulimin e shpenzimeve bazë të realizimit.

5. Rekreacion sportiv – aktivitet fizik me qëllim të zhvillimit të aftësive psikofizike dhe shëndetit, pa pjesëmarrje në gara zyrtare sportive.
6. Program edukativ sportiv është aktivitet i organizuar i orientuar në zhvillimin e aftësive motorike, shëndetësore dhe sociale të fëmijëve dhe të rinjve.
7. Aktivitet sportiv vullnetar (dobiprurës) është aktiviteti që organizohet nga persona pa kompensim monetar për punën e tyre.
8. Fëmijë dhe të rinj janë personat deri në moshën 18 vjeç.

Neni 3.

Kompetenca dhe përgjegjësia e komunës

Kompetencat dhe përgjegjësitë e komunës në fushën e sportit janë:

1. Miraton dhe zbaton akte normative në nivel komunal në fushën e sportit,
2. Zhvillon dhe menaxhon infrastrukturën sportive në nivel komunal në përputhje me dispozitat e Ligjit për Sport.

Neni 4.

Fushëveprimi i rregullores

Rregullorja:

1. Përcakton funksionet e hapësirave sportive,
2. Përcakton kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit të palestrës sportive në pronësi të komunës,
3. Përcakton prioritetet në orarin e termineve,
4. Përcakton lartësinë dhe bazën e pagesës së tarifës,
5. Përcakton kushtet për lirim nga pagesa,
6. Përcakton të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shfrytëzuesve.

Neni 5.

Interesi publik

Zhvillimi i sportit për fëmijë dhe të rinj, aktiviteteteve sportive shkollore dhe programeve vullnetare konsiderohet veprimtari me interes publik.

Neni 6.

Funksioni i palestrës sportive

Funksioni primar i palestrës sportive është krijimi i kushteve për zhvillimin e sportit, aktiviteteteve rekreative, koncerteve, tubimeve dhe organizimit të ngjarjeve ekonomike. Në palestër mund të mbahen ndeshje dhe stërvitje për sporte të mbyllura, si basketbolli, hendbolli, volejbolli, futsalli në ambiente të mbyllura dhe sporte të tjera të licencuara.

Në palestër mund të mbahen edhe aktivitete të tjera sportive që nuk paraqesin rrezik për dëmtimin e dyshemesë ose hapësirave, aktivitete promovuese dhe tubime politike.

Neni 7.

E drejta e shfrytëzimit të palestrës sportive

Të drejtën e shfrytëzimit të palestrës sportive e kanë:

1. Komuna,
2. programe edukative jofitimprurëse për fëmijë,
3. programe vullnetare,
4. organizata joqeveritare,
5. grupe formale dhe joformale.

Neni 8.

Mënyra e shfrytëzimit të palestrës sportive

Shfrytëzimi i palestrës sportive bëhet me marrëveshje ndërmjet palës së interesuar dhe menaxherit të palestrës sportive. Kontrata përmban: termin dhe kohëzgjatjen e shfrytëzimit, qëllimin e aktivitetit, statusin (falas/komercial) dhe detyrimet e shfrytëzuesit.

Pala e interesuar duhet të parashtrijë kërkesë së paku 3 ditë para mbajtjes së aktivitetit.

Neni 9.

Rregullat themelore për shfrytëzimin e palestrës sportive (rendi shtëpiak)

1. Në rast ankese, shfrytëzuesi duhet t'i paraqesë ankesë DKRS-së.
2. Menaxheri ka të drejtë ta pezullojë përkohësisht shfrytëzuesin në rast të mosrespektimit të rregullores.
3. Pirja e duhanit është rreptësisht e ndaluar në të gjitha hapësirat e palestrës.
4. Pas shfrytëzimit të hapësirave të palestrës, ato duhet të kthehen në gjendjen në të cilën janë pranuar.
5. Administrata nuk mban përgjegjësi për sendet personale të humbura në palestër.
6. Shfrytëzimi i nënshtrohet pagesës sipas tarifës së përcaktuar me nenin 11 të kësaj rregulloreje.
7. Pajisjet sportive duhet të jenë të përshtatshme për ambientin e palestrës.
8. Ndalohet hyrja në parket me këpucë që mund të shkaktojnë dëmtime.
9. Fëmijët më të vegjël se 16 vjeç duhet të jenë në shoqërimin e prindit ose kujdestarit.
10. Hyrja me kafshë është e ndaluar, përveç rasteve kur kafsha është mjet ndihmës për personat me aftësi të kufizuara.
11. Ndalohet bartja dhe përdorimi i të gjitha llojeve të mjeteve piroteknike dhe armëve në palestrën sportive, përveç sigurimit të autorizuar.
12. Ndalohet vendosja e posterëve dhe afisheve të tjera pa lejen e menaxherit.
13. Ndalohet tregtia dhe përdorimi i pijeve alkoolike në palestrën sportive.

Neni 10.

Vendosja e shpalljeve

Subjektet e interesuara mund të vendosin shpallje në hapësirat e palestrës duke paraqitur kërkesë te menaxheri i palestrës, ndërsa çmimi i reklamimit dhe kohëzgjatja e shpalljes përcaktohen më vonë.

Neni 11.

Ceniku për shfrytëzimin e palestrës sportive

1. Shfrytëzimi i palestrës sportive dhe hapësirave sportive përcjellëse mund të jetë falas ose me pagesë, në përputhje me këtë rregullore dhe tariforin që e miraton Kuvendi Komunal.

2. Tarifa për shfrytëzimin e palestrës sportive përcaktohet varësisht nga kohëzgjatja e terminit dhe lloji i aktivitetit.
3. Njësia bazë tarifore është 60 minuta, ndërsa shfrytëzuesit mund të marrin me qira termin në kohëzgjatje prej:
 - a) 60 minuta
 - b) 90 minuta
 - c) 120 minuta

Tarifa për termin prej 90 dhe 120 minutash përcaktohet në përpjesëtim me tarifën bazë.

Fëmijët, nxënësit, programet sportive vullnetare dhe aktivitetet me interes publik mund të lirohen pjesërisht ose tërësisht nga pagesa, në përputhje me këtë rregullore.

Menaxheri i palestrës sportive është i obliguar që ceniku të jetë i afishuar publikisht në hapësirat e palestrës sportive dhe në faqen zyrtare të internetit të komunës.

CENIKU – Palestra sportive

Kohëzgjatja e terminit	Çmimi
60 minuta	10€
90 minuta	15€
120 minuta	20€

Neni 12.

Kontrolli dhe mbikëqyrja

Mbikëqyrjen mbi zbatimin e kësaj rregulloreje e bën DKRS.

DKRS ka të drejtë të kontrollojë dokumentacionin dhe mënyrën e rregullimit të aktiviteteve të përcaktuara në nenin 1.

Neni 13.

Masat ndëshkuese

Mosrespektimi i dispozitave të kësaj rregulloreje sjell ndalim të përkohshëm të shfrytëzimit të palestrës.

Në rast të shkeljeve të përsëritura, shfrytëzimi mund të ndalohej përgjithmonë.

Në rast se shfrytëzuesi fsheh përfitimin komercial ose keqpërdor statusin e aktivitetit

jofitimprurës, humb të drejtën e shfrytëzimit të palestrës për një periudhë të caktuar kohore.

Dëmi material duhet të kompensohet brenda 10 ditësh.

Vlerësimin e dëmit e bën komisioni treanëtarësh.

Në rast të mospagesës së kompensimit, procedura vazhdon para organit gjyqësor.

Neni 14.

Transparenca

DKRS është e obliguar që një herë në gjashtë muaj t'i dorëzojë Kuvendit raport për:

1. numrin e termineve falas,
2. numrin e termineve komerciale,
3. efektet financiare të zbatimit të rregullores.

Neni 15.

Zbatimi

Për zbatimin e kësaj rregulloreje kompetente është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Kryetari i Komunës dhe drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport kujdesen për zbatimin e saj të drejtë dhe të ligjshëm.

Neni 16.

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit të organi mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, në lidhje me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve Komunale, si dhe 7 ditë pas publikimit publik në tabelën e shpalljeve ose në faqen zyrtare të internetit të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Zveçanit

Dr. Srđan Milosavljević